

University of Prishtina “Hasan Prishtina”

Faculty of Philology

Department of Literature



Candidate: Lorita FEJZA

The Typology of Women Characters in the Literary Works of D.H. Lawrence, James Joyce, and F. Scott Fitzgerald

Doctoral Thesis

Mentor: Assoc. Prof. Dr. Seniha KRASNIQI

Prishtina, 2026

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

Fakulteti i Filologjisë

Departamenti i Letërsisë



Kandidate: Lorita FEJZA

**Tipologjia e personazheve gra në veprat
letrare të autorëve D.H. Lawrence, James
Joyce dhe F. Scott Fitzgerald**

PUNIMI I DOKTORATËS

Mentore: Assoc. Prof. Dr. Seniha Krasniqi

Prishtinë, 2026

Rezimeja në gjuhën angleze

This dissertation examines the ways in which women characters are constructed, function, and acquire meaning in early twentieth-century modernist literature, with particular focus on the works of **D. H. Lawrence, James Joyce, and F. Scott Fitzgerald**. The main aim of the study is to demonstrate that women characters are not merely secondary or decorative elements of literary narrative; rather, they constitute central narrative and ideological structures through which the fundamental tensions of modernity are articulated. These tensions include the conflict between tradition and change, between patriarchal norms and the demand for individual autonomy, and between social order and subjective desire.

The study places at its center the concept of **character typology**, analyzing the psychological complexity of women figures, their function in the structural development of the narrative, and the degree of agency they possess within the fictional world. In this sense, the dissertation argues that modernism represents a transitional stage in the literary representation of women: the traditional model of submissive femininity begins to destabilize, yet it is not fully replaced by a socially equal and autonomous women figure.

The literary corpus selected for analysis includes the major works of the three authors: *Sons and Lovers*, *Women in Love*, and *Lady Chatterley's Lover* by D. H. Lawrence; *Dubliners*, *A Portrait of the Artist as a Young Man*, and *Ulysses* by James Joyce; and *This Side of Paradise*, *The Great Gatsby*, and *Tender Is the Night* by F. Scott Fitzgerald. The selection of these authors is based on their canonical status within modernism, their belonging to three distinct cultural contexts, English, Irish, and American, and the strong and varied presence of women characters in their works. This cultural and aesthetic diversity enables a comparative analysis and the identification of typological patterns that transcend national boundaries.

Theoretically, the dissertation is grounded in two principal frameworks: **classical narratology** and **contemporary feminist theory**. From narratology, it adopts E. M. Forster's distinction between "flat" and "round" characters in order to classify women figures according to their psychological development and narrative complexity. In parallel, Tzvetan Todorov's structural model of

equilibrium, disequilibrium, and the establishment of a new narrative order is employed to analyze the role of women in the progression of events and the transformation of the initial narrative situation.

This narratological approach is complemented by a broad feminist framework that includes **Simone de Beauvoir's** concept of woman as the "Other," **Judith Butler's** theory of gender performativity, **Kimberlé Crenshaw's** notion of intersectionality, and **Luce Irigaray's** critique of phallogentric discourse. These theoretical perspectives enable the interpretation of women characters not only as structural elements within narrative but also as products of gendered power relations and as potential forms of resistance against them.

Methodologically, the dissertation combines **close textual analysis**, typological classification, narratological examination of structural functions, and feminist interpretation. A comparative approach is employed in order to examine how women characters operate across different authors and cultural contexts. Each woman character is analyzed in relation to her typological category, her narrative function, and her ideological positioning within the gender discourse of the text.

An important section of the study is also devoted to the **social and historical context** of England, Ireland, and the United States in the late nineteenth and early twentieth centuries. The dissertation examines the legal and economic limitations imposed on women, the moral norms regulating their behavior, the role of marriage as a social institution, and the early signs of women's emancipation. This historical context helps explain why many women characters experience a profound tension between the aspiration for independence and the social pressure toward conformity.

The analysis of D. H. Lawrence's works reveals that women are often portrayed as emotionally and sexually complex figures possessing a strong degree of self-awareness and a tendency to challenge traditional gender roles. Characters such as Ursula and Gudrun Brangwen or Connie Chatterley are typically "round" characters who directly influence the psychological development of male protagonists and frequently generate narrative disequilibrium. At the same time, the study identifies an ideological ambiguity in Lawrence's work: although he promotes forms of women's autonomy, these are often accompanied by new patterns of erotic and emotional domination.

In the works of James Joyce, women frequently appear constrained by powerful social, religious, and colonial structures. Figures such as Eveline or Maria remain trapped in a state of existential paralysis and represent a typology of static characters. In contrast, Molly Bloom constitutes one of the most radical women figures of modernism: she gains narrative authority, articulates women's desire without censorship, and challenges the traditional silence imposed upon women. Joyce thus places the women's voice at the center of narrative consciousness, even within a social world that still denies women full freedom.

In the fiction of F. Scott Fitzgerald, women characters are closely connected to the structures of social class and to the aesthetics of American desire. Daisy Buchanan and Nicole Diver appear as complex figures; however, their autonomy remains limited by economic dependence and the norms of elite society. They simultaneously symbolize the promise of the American Dream and its moral emptiness, often functioning more as objects of male projection than as fully autonomous subjects of action.

At a comparative level, the dissertation identifies two fundamental typological patterns: women characters who contribute to the preservation of social and narrative order, and those who destabilize that order by generating conflict, transformation, and narrative reorganization. These destabilizing figures, such as Ursula Brangwen, Gudrun Brangwen, Molly Bloom, and Nicole Diver, are interpreted as key figures for the modernist aesthetics of crisis and transition.

Drawing on Todorov's model, the study argues that women are frequently the primary agents responsible for the shift from initial equilibrium to narrative disequilibrium and, in some cases, for the establishment of a new narrative order. This positions them as structural engines of the narrative rather than passive participants in the development of events.

The feminist and intersectional analysis further demonstrates that the experiences of women characters are shaped not only by gender but also by social class, education, economic status, and cultural context. This explains why women's freedom in Fitzgerald tends to remain largely symbolic, why in Lawrence it appears more bodily and emotional, and why in Joyce it often takes the form of linguistic and psychological autonomy.

In conclusion, the dissertation argues that women characters in modernist literature function as **central structures in the construction of literary meaning and in the articulation of the cultural crisis of the period**. They act as agents of conflict and transformation, while their typology reflects the persistent tension between patriarchal tradition and modernity. None of the authors studied offers a complete model of women`s emancipation; however, all three document the complex and contradictory process through which new forms of gendered subjectivity emerge.

The scholarly contribution of this dissertation lies in the **systematic integration of narratology and feminist theory**, offering an analytical model that may also be applied to other studies of modernism and gender representation in literature. The study suggests that future research could expand the corpus to include modernist women writers, apply this typological model to postmodern literature, or examine the construction of masculinity in the same texts as a complementary field of inquiry.

Rezymeja në gjuhën shqipe

Ky punim doktrate shqyrton mënyrat se si ndërtohen dhe funksionojnë personazhet gra në letërsinë moderniste të fillimshkullit XX, me fokus të veçantë në veprat e D. H. Lawrence, James Joyce dhe F. Scott Fitzgerald. Qëllimi kryesor i studimit është të demonstrojë se personazhet gra nuk përbëjnë elemente dytësore apo thjesht dekorative të rrëfimit letrar, por janë struktura narrative dhe ideologjike qendrore përmes të cilave artikulojnë tensionet themelore të modernitetit: konflikti ndërmjet traditës dhe ndryshimit, ndërmjet normave patriarkale dhe kërkesës për autonomi individuale, si dhe ndërmjet rendit shoqëror dhe dëshirës subjektive.

Punimi vë në qendër konceptin e tipologjisë së personazhit, duke analizuar shkallën e kompleksitetit psikologjik të personazheve gra, funksionin e tyre në zhvillimin strukturor të rrëfimit dhe nivelin e agjencisë që ato zotërojnë brenda botës narrative. Në këtë kuptim, studimi synon të tregojë se modernizmi përfaqëson një fazë tranzicioni në përfaqësimin e gruas, ku modeli tradicional i feminitetit të nënshtruar fillon të lëkundet, por pa u zëvendësuar plotësisht nga një figurë e lirë dhe e barabartë shoqërisht.

Korpusi letrar i përzgjedhur përfshin romanet kryesore të tre autorëve: *Sons and Lovers*, *Women in Love* dhe *Lady Chatterley's Lover* të D. H. Lawrence; *Dubliners*, *A Portrait of the Artist as a Young Man* dhe *Ulysses* të James Joyce; si dhe *This Side of Paradise*, *The Great Gatsby* dhe *Tender Is the Night* të F. Scott Fitzgerald. Zgjedhja e këtyre autorëve bazohet në statusin e tyre kanonik brenda modernizmit, në përkatësinë e tyre në tri kontekste kulturore të ndryshme – anglez, irlandez dhe amerikan – si dhe në praninë e fortë dhe të larmishme të personazheve gra në veprat e tyre. Ky diversitet kulturor dhe estetik mundëson një analizë krahasuese të thelluar dhe identifikimin e modeleve tipologjike që shfaqen përtej kufijve kombëtarë.

Në aspektin teorik, disertacioni mbështetet në dy shtylla kryesore: narratologjinë klasike dhe teorinë feministe bashkëkohore. Nga narratologjia përdoret ndarja e E. M. Forster-it ndërmjet personazheve “flat” dhe “round”, e cila shërben për të klasifikuar personazhet gra sipas nivelit të zhvillimit të tyre psikologjik dhe kompleksitetit narrativ. Paralelisht, modeli strukturor i Tzvetan Todorovit mbi ekuilibrin, disekuilibrin dhe vendosjen e një rendi të ri narrativ përdoret për të analizuar rolin e grave në lëvizjen e ngjarjes dhe në transformimin e situatës fillestare të rrëfimit.

Kjo qasje plotësohet nga një kornizë e gjerë feministe, e cila përfshin konceptin e gruas si “Tjetri” të Simone de Beauvoir-it, teorinë e performativitetit gjinor të Judith Butler-it, nocionin e interseksionalitetit të Kimberlé Crenshaw-it dhe kritikën e diskursit fallocentrik të Luce Irigaray-së. Këto perspektiva teorike mundësojnë interpretimin e personazheve gra jo vetëm si elemente strukturore të rrëfimit, por edhe si produkte të marrëdhënieve të pushtetit gjinor dhe si forma të rezistencës ndaj tyre.

Metodologjikisht, punimi kombinon analizën e detajuar tekstuale me klasifikimin tipologjik, analizën narratologjike të funksioneve strukturore dhe interpretimin feminist, duke përdorur një qasje krahasuese ndërmjet autorëve dhe konteksteve kulturore përkatëse. Çdo personazh gruashqyrtohet në raport me tipologjinë e tij, funksionin që kryen në strukturën narrative dhe pozicionimin ideologjik brenda diskursit gjinor të tekstit.

Një pjesë e rëndësishme e studimit i kushtohet edhe kontekstit shoqëror dhe historik të Anglisë, Irlandës dhe Shteteve të Bashkuara në fund të shekullit XIX dhe fillim të shekullit XX. Analizohen kufizimet ligjore dhe ekonomike të grave, normat morale që rregullonin sjelljen e tyre, roli i

martesës si institucion shoqëror dhe shenjat e para të emancipimit të gruas. Ky kontekst shërben për të shpjeguar pse shumë personazhe gra përjetojnë një ndarje të thellë ndërmjet aspiratës për pavarësi dhe presionit shoqëror për konformizëm.

Analiza e veprave të D. H. Lawrence tregon se gratë paraqiten si figura emocionalisht dhe seksualisht të ndërlikuara, me një nivel të lartë vetëdijeje dhe me prirje për të sfiduar rolet tradicionale gjinore. Personazhe si Ursula dhe Gudrun Brangwen apo Connie Chatterley janë zakonisht personazhe “round”, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin psikologjik të personazheve mashkullore dhe shpesh shkaktojnë disekuilibër narrativ. Megjithatë, studimi evidenton edhe ambiguitetin ideologjik të Lawrence-it, i cili, ndonëse promovon forma të reja të autonomies së gruas, shpesh i shoqëron ato me struktura të reja të dominimit erotik dhe emocional.

Në veprën e James Joyce-it, gratë shfaqen shpesh të kufizuara nga struktura të forta sociale, fetare dhe koloniale. Figura si Eveline apo Maria mbeten të bllokuara në një gjendje paralizë ekzistenciale dhe përfaqësojnë tipologjinë e personazheve statike. Në kontrast me to, Molly Bloom përbën një nga figurat më radikale të modernizmit, pasi ajo fiton autoritet narrativ, artikulon dëshirën e grave pa censurë dhe sfidon heshtjen tradicionale të imponuar mbi gratë. Joyce, në këtë mënyrë, e vendos gruan në qendër të vetëdijes narrative, por brenda një bote që ende nuk i garanton asaj liri reale shoqërore.

Te F. Scott Fitzgerald, personazhet gra janë të lidhura ngushtë me strukturat e klasës shoqërore dhe me estetikën e dëshirës amerikane. Daisy Buchanan dhe Nicole Diver paraqiten si figura komplekse, por autonomia e tyre mbetet e kufizuar nga varësia ekonomike dhe normat e elitës shoqërore. Ato simbolizojnë njëkohësisht ëndrrën amerikane dhe zbrazëtinë e saj morale, duke funksionuar shpesh si objekte të projektive mashkullore më shumë sesa si subjekte të plota veprimi.

Në nivel krahasues, disertacioni identifikon dy modele themelore tipologjike: personazhet gra që kontribuojnë në ruajtjen e rendit shoqëror dhe narrativ, dhe personazhet që e destabilizojnë atë rend, duke krijuar konflikt, transformim dhe riorganizim të strukturës së rrëfimit. Pikërisht këta personazhe destabilizues, si Ursula Brangwen, Gudrun Brangwen, Molly Bloom dhe Nicole Diver, shihen si figura kyçe për estetikën moderniste të krizës dhe tranzicionit.

Duke u mbështetur në modelin e Todorovit, studimi argumenton se gratë janë shpesh shkaktaret kryesore të kalimit nga ekuilibri fillestar në disekuilibër dhe, në disa raste, kontribuojnë në vendosjen e një rendi të ri narrativ. Kjo i pozicionon ato si motorë strukturorë të rrëfimit dhe jo si elemente pasive të zhvillimit të ngjarjeve.

Analiza feministe dhe interseksionale tregon se përvoja e personazheve gra nuk përcaktohet vetëm nga gjinia, por edhe nga klasa shoqërore, niveli i edukimit, statusi ekonomik dhe përkatësia kulturore. Kjo shpjegon pse liria e grave të Fitzgerald mbetet kryesisht simbolike, pse të Lawrence ajo shfaqet më trupore dhe emocionale, dhe pse të Joyce merr kryesisht formën e një autonomie gjuhësore dhe mendore.

Në përfundim, disertacioni argumenton se personazhet gra në letërsinë moderniste janë struktura qendrore për ndërtimin e kuptimit letrar dhe për artikullimin e krizës kulturore të epokës. Ato funksionojnë si agjentë të konfliktit dhe ndryshimit, ndërsa tipologjia e tyre pasqyron tensionin e vazhdueshëm ndërmjet traditës patriarkale dhe modernitetit. Asnjë nga autorët e studiuar nuk ofron një model të emancipimit të plotë të grave, por të tre dokumentojnë procesin kompleks dhe kontradiktor të tranzicionit drejt forma më të reja të subjektivitetit gjinor.

Kontributi shkencor i këtij punimi qëndron në integrimin sistematik të narratologjisë me teorinë feministe, duke ofruar një model analitik të aplikueshëm edhe për studime të tjera mbi modernizmin dhe përfaqësimin e gjinisë në letërsi. Studimi sugjeron se kërkime të ardhshme mund të zgjerojnë korpusin me autore gra moderniste, të aplikojnë këtë model tipologjik në letërsinë postmoderniste ose të analizojnë në mënyrë komplementare ndërtimin e maskulinitetit në të njëjtat tekste letrare.

